



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE
PA1 nr.11-224
27.06.2023
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi (13) nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastuar) ark.nr.01-4139/1 datë 7.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.11-2558/1 datë 21.6.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2575/3 datë 27.6.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 20-të mbajtur më 26.6.2023, miratoi si vijon:

AKTVENDIM

për paralajmërim publik dhe për ndërprerjen e ritransmetimit të shërbimit programor

- PUBLIKISHT PARALAJMËROHET** Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për prodhim dhe tregti TOTAL TV SHPK Shkup, për ritransmetimin e shërbimit programor i cili nuk është i regjistruar në Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) në pajtim me nenin 141 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV). Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-2558/1 datë 21.6.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.
- URDHËROHET** Operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik, Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, menjëherë pas pranimit të këtij aktvendimi të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV, respektivisht të ndërpresë ritransmetimin e shërbimit programor.
- Të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të kostatuar nëse subjekti i mbikëqyrur i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit për paralajmërim publik dhe për ndërprerjen e ritransmetimit të shërbimit programor.
- Nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, nuk ka vepruar sipas aktvendimit respektivisht vazhdon të kryejë shkelje për të cilën është paralajmëruar publikisht, Agjencia, në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 2 nga LSHMAAV, do të paraqesë kërkesë për fillimin e procedurës për kundërvajtje para gjykatës kompetente.
- Ky Aktvendim është përfundimtar, dhe si ditë për miratimin e tij konsiderohet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë.

A r s y e t i m

Agjencia në pajtim me nenin 6 paragrafi (1) nënparagrafi 4 nga LSHMAAV ndërmerr masa në pajtim me këtë Ligj në rastet kur kemi të bëjmë me shkelje të dispozitave nga LSHMAAV ose të rregulloreve miratuar në bazë të ligjit dhe kushteve dhe detyrimeve për lejet.

Në bazë të nenit 28 nga LSHMAAV, Agjencia është kompetente të kryen mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimit mediatik audiovizuel sipas kërkesës, si dhe të pakove programore që ritransmetohen nga operatorët e rrjetit publik të komunikimit elektronik në aspekt të respektimit të dispozitave nga Ligji i njëjtë, lejeve, çertifikatat e dhëna për regjistrim, aktet nënligjore dhe akte të tjera miratuar nga Agjencia.

Në kuadër të kompetencave ligjore, dhe në pajtim me nenin 27 dhe nenin 28 nga LSHMAAV, Agjencia më 20.6.2023, ka kryer mbikëqyrje të rregullt të shërbimeve programore të ritransmetura nga ana e operatorit Shoqëria për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, nga ku është konstatuar se operatori i cekur që sipas notifikacionit nga Agjencia për Komunikim Elektronik mund të ushtrojë veprimtarinë e tij në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbim programor që nuk është i pajisur me vërtetimin për regjistrim të shërbimi programor i dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Konstatimet nga mbikëqyrja janë të detajuara në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-2558/1 datë 21.6.2023, si pjesë përbërëse e këtij aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 nga LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 141 paragrafi 13 nga Ligji i njëjtë, pika 8 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.11-2558/1 datë 21.6.2023 dhe Konkluzionin ark.nr.02-2575/3 datë 27.6.2023, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave nga LSHMAAV cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, Këshilli i Agjencisë, miratoi aktvendim ku ndaj subjektit të lartpërmendur ndërmerret masë paralajmërim publik dhe detyrohet që pas pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat nga LSHMAAV, duke ndërprerë ritransmetimin e shërbimit programor.

Agjencia do kryej mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i cekur veproi sipas urdhëresës, respektivisht pas paralajmërimit publik nëse ka ndërprerë ritransmetimin e shërbimit programor.

Në pajtim me nenin 24 nga LSHMAAV, ky aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar në sa më sipër u mor aktvendim si në dispozitiv.

Shojcë (1):

- Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore, ark.nr.11-2558/1 datë 21.6.2023.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,**

Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi operatori i rrjetit publik të komunikimit elektronik ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.